



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës B (4)

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti III / Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti aftësohet të njohë proceset e zhvillimit të historisë së letërsisë italiane bashkëkohore [gjysma e dytë e shek. XX-XXI]. Të lexojë vepra të disa autoreve të ndryshëm, të sugjeruar nga profesori apo dhe zgjedhje e tij e lirë. Studenti komenton tekste letrare dhe shkruan ese mbështetur mbi një mendim analitik. Njeh autorë e vepra si perfaqësues estetikash letrare dhe rrymash artistike. Ai analizon dhe formon një gjykim personal, të arësyeshëm dhe aktiv mbi momentet kyce të letërsisë italiane në periudhën në studim.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të jetë i aftë të njohë lëvizjet artistike më të rëndësishme bashkëkohore në letërsi, përfshirë autorët dhe veprat letrare përfaqësuese, përgjatë shekujve XX, XXI deri në ditët tona si: Neorealizmi, Neoavangarda, Postmodernizmi, letërsia Eksperimentale e Bashkëkohore.
2. Të jetë i aftë të paraqesë një panoramë të letërsisë bashkëkohore në Itali dhe ndikimin që kjo letërsi ka nga ajo evropiane dhe botërore.
3. Të jetë i aftë të realizoj kritikë personale letrare, memorizon poezi të autorëve të ndryshëm, përkthen poezi shkruan ese.

Rezultate të pritshme:

1. Studenti fiton aftësinë për të zhvilluar kompetencën e arësytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së eseve dhe projekteve përgjatë kursit.
2. Studenti fiton aftësinë për të ushtruar mendimin analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e fenomeneve të ndryshme letrare apo rrymave letrare.
3. Studenti zhvillon aftësinë për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njeh terminologjinë bazë. Studenti zhvillon kompetencën dixhitale: aftësinë për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet.
4. Studenti zhvillon kompetencën shoqërore dhe qytetare: nxitet puna në grup dhe sensibilizohet për temat sociale. Studenti zhvillon kompetencën ndërkulturore: aftësinë për të njohur proceset letrare e historike, të plurikulturalizmit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit kulturor.
5. Studenti zhvillon kompetencën e vetëformimit të vazhdueshëm: e të mësuarit se si të formohet gjatë gjithë jetës. Kjo lidhet ngushtë me aftësinë për të zgjedhur tema hulumtuese që mund të ngjallin debate letrare dhe të punuarit në mënyrë të pavarur dhe me inisiativë.